



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE



Republika e Kosovës - Република Косова - Republic of Kosovo
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

MARRËVESHJE MBI BASHKËPUNIMIN RECIPROK DHE NDIHMËN E
NDËRSJELLTË NË FUSHA ME INTERES TË PËRBASHKËT MIDIS

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kryetarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

Në emër dhe si përfaqësues të të dyja Gjykatave, të autorizuar respektivisht;

Duke pasur parasysh se në fushën e marrëdhënieve reciproke ekziston një interes i përbashkët për thellimin dhe shkëmbimin e njohurive mbi jurisprudencat respektive, teknikat e vendimmarrjes dhe modelet përkatëse të organizimit dhe funksionimit;

Duke konsideruar mundësinë e realizimit, në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, të shkëmbimit të njohurive dhe të studimeve nëpërmjet informacioneve periodike mbi jurisprudencat respektive, shkëmbimin e dokumentacionit dhe organizimin e vizitave reciproke midis gjyqtarëve të të dyja Gjykatave, duke parashikuar gjithashtu mundësinë e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive me karakter formues (*stazheve*) pranë selive respektive, si në ndihmë të këshilltarëve ligjor ashtu edhe të stafit administrativ të këtyre dy gjykatave, kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1: Programet e planifikuara bashkërisht:

- a) do të kryhen periodikisht, në mirëkuptim midis palëve, vizita reciproke të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe Gjykatës Kushtetuese të Kosovës;
- b) do të organizohen, në mirëkuptim midis palëve, periudha *stazhi* në ndihmë të këshilltarëve ligjor të Gjyqtarëve dhe të stafit administrativ të të dyja Gjykatave;
- c) do të zërë vend një shkëmbim periodik informacioni mbi jurisprudencat respektive kushtetuese; secila nga palët do t'i dërgoj tjetrës dokumentacionin e kërkuar në çdo rast, legjislacionin, jurisprudencën mbi tema të veçanta.

Neni 2: Modalitetet e bashkëpunimit:

a) Veprimtaritë trajnuese

- aa) Palët mund të zhvillojnë programe trajnuese të përbashkëta që lidhen me fushat e veprimtarisë së tyre, si dhe për tematika të tjera për të cilat mund të bihet dakord.
- ab) Palët mund të ftojnë njëra tjetrën në programet trajnuese që organizohen në institucionet e tyre.
- ac) Palët mund të shkëmbejnë trajnuesit, materialet informuese dhe trajnuese si paketat trajnuese, librat, prodhimet audio – vizuale etj., të përgatitura nga departamentet e tyre përgjegjëse për trajnimin.

b) Studimet/kërkimet

- ba) Palët mund të bien dakord të kryejnë studime/kërkime të përbashkëta mbi tema që lidhen me funksionet e tyre.
- bb) Palët mund të shkëmbejnë ekspertët e tyre për temat e studimeve/kërkimeve sikurse mund të bihet dakord.

c) Seminaret

- ca) Palët mund të ftojnë njëra tjetrën në programet e trainimit që organizohen në institucionin e tyre.
- cb) Palët mund të organizojnë seminare të përbashkëta mbi temat për të cilat mund të bihet dakord.

d) Shkëmbimet e njohurive dhe përvojave

- da) Palët mund të shkëmbejnë njohuri dhe përvoja mbi temat dhe sipas mënyrave për të cilat do të bihet dakord.
- db) Palët mund të shkëmbejnë delegacione dhe anëtarë të stafeve të tyre me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe përvojave.

e) Veprimtari të tjera për bashkëpunimin

ea) Me marrëveshje me shkrim mes Palëve mund të organizohen edhe veprimtari të tjera për bashkëpunimin.

Neni 3: Mbulimi i shpenzimeve

Shpenzimet e qëndrimit të gjyqtarëve kushtetues do t'i ngarkohen Gjykatës pritëse. Për periudhat e *stazhit*, shpenzimet e qëndrimit të këshilltarëve ligjor të gjyqtarëve dhe të stafit administrativ do të jenë në ngarkim të Gjykatës pritëse, ndërsa shpenzimet e udhëtimit do të jenë në ngarkim të Gjykatës mike.

Neni 4: Zgjerimi i bashkëpunimit

Në periudha periodike, dhe në selitë respektive, do të organizohen, me mirëkuptim midis palëve dhe aktivitete mbi tema të miratuara bashkërisht, vizita studimore të gjyqtarëve të dy organeve të drejtësisë kushtetuese dhe, në rast se, të dyja palët bien dakord, edhe me përfaqësues të Gjykatave ose Gjykatave Kushtetuese të rajonit.

Neni 5: Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 1) Kjo marrëveshje është e vlefshme për 5 vjet, dhe i fillon efektet që nga data e hyrjes në fuqi.
- 2) Ky afat mund të shtyhet për periudha të njëjta, me marrëveshje të heshtur nga palët.

Neni 6: Përfundimi i marrëveshjes

- 1) Marrëveshja pushon së qeni e vlefshme me deklaram të palëve, brenda 3 muajve nga përfundimi i periudhës 5 vjeçare.
- 2) Në rast se njëra prej palëve tërhiqet nga kjo marrëveshje para kohe, duhet të informojë me shkrim palën tjetër, lidhur me përfundimin e kësaj marrëveshje.


Neni 7: Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje, e përpiluar në gjuhën shqipe, anglishte dhe serbishte, të tri versionet e hartuara njëllon në mirëbesim, do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit nga ana e Kryetarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

E përpiluar dhe e nënshkruar në tri kopje, në gjuhën shqipe, anglishte dhe serbishte, që dy palët e shkëmbejnë.

KRYETARI I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË


Zoti Bashkim DEDJA



Tiranë, më 18.04.2011

KRYETARI I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prof. Dr. Enver HASANI



Tiranë, më 18.04.2011



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE**



**Republika e Kosovës - Република Косова - Republic of Kosovo
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

**MEMORANDUM OF UNDERSTANDING ON RECIPROCAL CO-OPERATION
MUTUAL ASSISTANCE IN AREAS OF COMMON INTEREST BETWEEN**

**THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA
AND
THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO**

The President of the Constitutional Court of the Republic of Albania and the President of the Constitutional Court of the Republic of Kosovo;

On behalf of both courts, and as representatives respectively authorized;

Taking into considering the common interest that does exist in the realm of reciprocal relations with regard to the further deepening and the exchanging of knowledge about respective case laws, decision-making technique and models of organization and functioning;

Taking into considering the possibility of constant and sustainable realization of the exchange of expertise and studies through the exchange of documentation and periodical information on the respective case laws, the organization of reciprocal study visits among the judges of both courts, providing also for the possibility to organize and put into practice activities of constructive character (training periods) at the respective seats with the aim to

assist the legal advisers to the judges and the administrative staff of both Courts, have agreed as follows:

Article 1: Jointly scheduled programs:

- a) Upon understanding between parties, reciprocal study visits among the judges of the Constitutional Court of Albania and the Constitutional Court of Kosovo will be periodically realized;
- b) Upon understanding between parties, training periods with the aim to assist the legal advisers to the judges and the administrative staff of both courts will be organized;
- c) A periodical exchange of information on respective constitutional case laws will take place; each of the parties shall send to the other one the requested documentation – as the case might be - the legislation, the case law on special issues.

Article 2: Modalities of co-operation:

a) Training activities:

aa) Parties may develop joint training programs related to the areas of their activity, as well as to the other topics they may agree upon.

ab) Parties may invite each-other to training programs that will be organized at their institutions.

ac) Parties may exchange trainers, information and training materials, as well as training packages, books, audio – visual products, etc., prepared by their respective departments for the training.

b) Studies/researches

ba) Parties may agree to realize joint studies/researches on topics related to their functions.

bb) Parties may exchange their experts on their study/research topics, as it may be agreed on.

c) Seminars

ca) Parties may invite each-other to training programs that will be organized at their institution;

cb) Parties may organize joint seminars on topics they will agree upon.

d) Exchange of expertise and experience

da) Parties may exchange their expertise and experiences on topics in accordance with the ways it has been agreed upon.

db) Parties may exchange delegations and members of their staff in order to exchange expertise and experiences.

e) Other cooperation activities

ea) Other cooperation activities may be organized between the parties through a written agreement.

Article 3: Covering of expenses

The stay expenses of the constitutional judges shall be covered by the hosting court. For the periods, the stay expenses of the legal advisors to the judges and of the administrative staff shall be covered by the hosting court, whereas the travel expenses shall be covered by the visiting court.

Article 4: Extension of co-operation

Upon understanding between parties, on periodical basis and at the respective seats, will be organized activities on topic jointly agreed upon, study visits among judges of the constitutional courts and, if both parties agree, even among representatives of other courts or constitutional courts in the region.

Article 5: Duration of memorandum of understanding

- 1) This memorandum of understanding is valid for 5 years, and it will produce effects as of the day of its entry into force.
- 2) This duration may be extended to the same periods of time, through a silent agreement by the parties.

Article 6: Conclusion of memorandum of understanding

- 1) Upon declaration from the parties, the memorandum of understanding shall no longer be valid, within 3 months from the expiration of the 5 year period.
- 2) If one of the parties withdraws from this memorandum of understanding, it is obliged to notify the other party in written regarding the conclusion of this memorandum of understanding.

Article 7: Entry into force

This memorandum of understanding, drafted in Albanian, English and Serbian languages, all the three versions being identical in good faith, will enter into force upon signature by the President of the Constitutional Court of Albania and the President of the Constitutional Court of the Republic of Kosovo.

This Memorandum of Understanding is drafted and signed in three copies, in Albanian, English and Serbian languages, so that the parties can exchange it.

THE PRESIDENT OF THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

Mr. Bashkim DEDJA



Tirana, on 18.04.2011

THE PRESIDENT OF THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Prof. Dr. Enver Hasani

Tirana, on 18.04.2011